

VENDIM
Nr.296, datë 14.4.2011

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NDËRMJET PROGRAMEVE, BRENDA
BUXHETIT TË VITIT 2011, MIRATUAR PËR MINISTRINË E ARSIMIT DHE
SHKENCËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Rishpërndarjen e fondeve ndërmjet programeve në buxhetin e vitit 2011, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, si më poshtë vijon:

a) Në programin “Arsimi profesional” (09240), të pakësohet fondi 10 599 000 (dhjetë milionë e pesëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë) lekë, në zërin “Shpenzime kapitale”.

b) Në programin “Arsimi bazë” (09230), të pakësohet fondi 52 041 000 (pesëdhjetë e dy milionë e dyzet e një mijë) lekë, në zërin “Shpenzime kapitale”.

c) Në programin “Arsimi i lartë” (09250), të shtohet fondi 62 640 000 (gjashtëdhjetë e dy milionë e gjashtëqind e dyzet mijë) lekë, në zërin “Shpenzime kapitale”.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha